



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E JUNIKUT

MUNICIPALITY OF JUNIK - OPŠTINA JUNI



Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Numër: 02/43;
Datë: 27.03.2015 .

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA Komuna Junik-Opština Junik		
02/Nr.Port.	Nr.i faq	Data
2-004-2880	2	27.04.2015

Në bazë të nenit 12.2 paragrafi d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22.1 paragrafi 4. të Statutit të Komunës së Junikut; dhe nenit 16 paragrafi 3. të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 27.03.2015, nxjerrë:

V E N D I M

për fillimin e hartimit të

(projekt) **Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Junikut**

- I. Me këtë vendim fillohet hartimi i (projekt)Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Junikut / në tekstin e mëtejme (projekt)rregullorja/.
- II. Qëllimi i nxjerrjes dhe miratimit të kësaj (projekt)rregulloreje, sipas këtij vendimi është organizimi dhe bashkëpunimi i Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane brenda territorit të komunës së Junikut në ushtrimin e aktiviteteve që janë të përcaktuara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës së Junikut.
- III. Bartëse e hartimit të (projekt)rregullores nga pika I. e këtij vendimi është Drejtoria për Administratë e Komunës së Junikut.
- IV. Bartësja e hartimit të (projekt)rregullores është e obliguar që rregulloren ta hartojë në afat prej 4 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
- V. Autorizohet kryetari i Komunës së Junikut që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të emëroj Grupin e punës për hartimin e (projekt)rregullores nga pika I. e këtij vendimi.
- VI. Projekt rregullorja duhet të vihet në shqyrtim publik dhe komente. Paraqitja e projekt rregullores në shqyrtim publik dhe koha për dhënien e shqyrtimeve dhe komenteve do të shpallen në ueb faqen e Komunës së Junikut.
- VII. Pas hartimit, (projekt)rregullorja i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
- VIII. Mjetet financiare për hartimin e (projekt)rregullores sigurohen nga buxheti i Komunës së Junikut.
- IX. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore me anën e të cilave kjo fushë ka qenë e rregulluar.

Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://rks-gov.net/junik>

X. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut respektivisht Drejtoria për Administratë e Komunës së Junikut.

XI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL;
2. Kryetari i Komunës së Junikut;
3. Drejtoria për Administratë;
4. Shërbimi i Kuvendit të Komunës së Junikut; dhe
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kuvendi i Komunës së Junikut

Faik Tofaj


Kryesues



Adresa:

Tel.: +386 (0) 49 760 270

<http://tks-gov.net/junik>